

## KOMITETI DREJTUES

Nr. 74 Prot.

Tiranë, 19.07.2024

### Vendim Nr. 3 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 19 korrik 2024, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Migena Plasa, z. Dritan Mema, z. Klevis Kaso, si dhe z. Blendi Dibra, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Ndryshime në Rregulloren e Aktiviteteve;
2. Organizimi i eventit “FIBA U16 EuroBasket Tirana 2024” – Divizioni C.
3. Ekipet Kombëtare Verë 2024;
4. Organizimi i eventit “FIBA U18 EuroBasket Elbasan 2024” – Divizioni C.
5. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilën pikë të sajë.

### **Për sa më sipër KD-ja vendosi:**

1. Lidhur me pikën 1 të rendit të ditës për Ndryshimet në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit:

- 1.1. Të hiqet kufizimi për maksimalisht 3 (tre) lojtarë/e të huaj në fushë.
- 1.2. Të hiqet vlera 5000 euro shtesë për regjistrim në muajin Shkurt.
- 1.3. Të lejohet regjistrim i lojtarëve/eve deri 14 ditë kalendarikë përpara fillimit të fazës Play Off.
- 1.4. Të hiqet tarifa e pjesëmarrjes në kampionatin kombëtar U20 djem;
- 1.5. Kampionati kombëtar meshuj të rritur me 11 ekipe ose me pak do të zhvillohet me 1 (një) kategori. Nëse do të ketë 12 ose më shumë ekipe, atëherë do të zhvillohet me dy kategori, Superliga me 6 ekipet e renditura më mirë në edicionin pararendës dhe ekipet e tjera në Kategorinë e I-rë.;
- 1.6. Seria e ndeshjeve finaleve meshkuj do të jetë me 5 (pesë) ndeshje të mundshme, duke u shpallur fitues ekipi që arrin të fitojë 3 (tre) ndeshje;

1.7. Seria e ndeshjeve 1/2 finaleve femra do të jetë me 5 (pesë) ndeshje të mundshme, duke u shpallur fitues ekipi që arrin të fitojë 3 (tre) ndeshje;

1.8. Tarifa e transferimit të lojtarëve/eve që kanë mbushur moshën 18 apo 19 vjeç, ose do të mbushin moshën 18 apo 19 vjeç deri në fund të muajit dhjetor të edicionit në vazhdim, do të jetë 50% më pak se vlera e përcaktuar për transferim në ekipet të rritur/a.

1.9. Vlerat e regjistrimit për lojtarët e huaj në kampionatet kombëtare meshkuj dhe femra të rritur/a do të jetë si më poshtë:

1.9.1 Per dy lojtarët e parë të regjistruar gjatë një edicioni sportiv do të jetë 1500 euro për kampionatin kombëtar meshkuj dhe 750 euro për kampionatin kombëtar femra.

1.9.2 Për çdo lojtarë/e të regjistruar pas lojtarit të dytë gjatë një edicioni sportiv, vlera e regjistrimit do të rritet me 50% më shumë se vlera e regjistrimit të lojtarit pararendës. Më poshtë shembull për llogaritjen e vlerës së regjistrimit për lojtarët e huaj të regjistruar në kampionatin kombëtar meshkuj pas dy lojtarëve të parë gjatë një edicioni sportiv:

Për regjistrim të lojtarit të tretë, vlera do të jetë 1500 euro + 50% e 1500 euro = 2250 euro

Për regjistrim të lojtarit të katërt, vlera do të jetë 2250 euro + 50 % e 2250 euro = 3375 euro

Për regjistrim të lojtarit të pestë, vlera do të jetë 3375 euro + 50 % e 3375 euro = 5062,5 euro

Etj.

\*Me të njëjtën formulë do të llogariten dhe transferimet e lojtareve të huaja në kampionatin kombëtar femra të rritura.

2. Komiteti Drejtues diskutoi lidhur me organizimin e kampionatit evropian U16 djem divizioni C, organizuar në Tiranë, 9 deri 14 korrik, duke analizuar raportet e aktivitetit të cilat paraqitën organizimin konform kërkesave të FIBA-s. U udhëzua financa për likuidimin e të gjitha detyrimeve financiare lidhur me aktivitetin, sipas raporteve përkatëse.

3. Lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, KD udhëzoi administratën për likuidimin e të gjitha detyrimeve financiare për organizimin e ekipeve kombëtare të cilat kanë mbyllur aktivitetin evropian.

4. Komiteti Drejtues diskutoi lidhur me organizimin e kampionatit evropian U18 djem divizioni C, e cila do të organizohet në Elbasan, 23 deri 28 korrik, duke analizuar raportet e aktivitetit. U udhëzua administrata për angazhim maksimal të sajë për realizim të aktivitetit komform kërkesave të FIBA-s.

5. Udhëzohet administrata për përgatitjen e planeve të veprimit lidhur me organizimin e kampionateve U20 djem dhe vajza, të cilat do të jenë pa tarifa të pjesëmarrjes. Në rast të mbështetjes nga sponsorë, kampionatet do të marrin emrin e sponsorit.